



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

VENDIM

“Mbi vlerësimin e dëmeve nga ana ndërtimore të familjes së **Z. Metush Sinan Maldi**, banor i fshatit Barbullush, Njësia Administrative Bushat”

Nr. 58, datë 22.11.2016

Bashkia Vau i Dejës pas ri-shqyrtimit të proces verbalit Nr.79/1, datë 30.06.2016 “Për konstatim të djegies se shtepise” të Komisionit të Verifikimit të Dëmeve (bashkëlidhur), Preventivin “Vlerësimi i orendive, mobiljeve dhe pajisjeve elektroshtepiake ” të Komisionit të ekspertëve të Këshillit të Qarkut Shkodër (bashkëlidhur).

Bazueshmëria ligjore: ligji Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; ligji Nr.8756 datë 26.03.2001 “Për emergjenat civile” i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave Nr.263 datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; Udhëzimit Nr.4 datë 30.09.2015 i KM “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2015, Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës për të përballuar dëmet e shkaktuara nga djegia e banese se **Z. Metush Sinan Maldi** e përbërë nga 1 anëtarënga fshati Barbullush, e ndodhur në datën 27.06.2016, Këshillit të Bashkisë me shumicë të cilësuar votash, ne mbledhjen e datës 22.11.2016:

VENDOSI:

1. Vlera e dëmit nga ana ndërtimore në shumën **1284215** (nje milion e dyqind e tetëdhjete e kater mije e dyqind e pesëmbëdhjete) leke dhe Vlerësimin e orendive, mobiljeve dhe pajisjeve elektroshtepiake ne vlerën **677.520** (gjashtëqind e shtatedhjete e shtate mije e peseqind e njezet) , për familjen e **Z. Metush Sinan Maldi** sipas preventivit të hartuar nga Ekspertet e Këshillit të Qarkut Shkodër “Vlerësimi i orendive, mobiljeve dhe pajisjeve elektroshtepiake ”
2. Ti popozojë Ministrisë së Punëve të Brendshme dhënien e diferencës midis ndihmës financiare të dhënë nga Këshilli i Bashkisë Vau i Dejës me vendimin nr.41, datë 22.07.2016 në vlerën 10.000 lekë (bashkëngjitur) dhe dëmeve të konstatuara nga ana ndërtimore dhe ne orjendi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Emergjencave Civile.
4. Ky vendim hyn ne fuqi sipas parashikimeve të nenit 55 pika 6 e Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
6. U shpall sot me datë 25.11.2016

SEKRETARI I KËSHILLIT
Gentian **NDOJ**



KRYETARI I KËSHILLIT
Martin **MARKU**

Adresa: Qyteti Vau Dejës, Rruga: “Qafa e Gurit”, Tel & Fax: 026120006, Email: bashkiavaudejës@hotmail.com